



*KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS SH.A.

**APLIKIMI TARIFOR
PËR VITIN 2012**

Pjesa II – Aplikimi Tarifor i Rregulluar për Gjenerim

5 janar 2012

Përmbajtja

I.	Hyrje.....	3
A.	Përmbledhje	3
B.	Definicionet	3
C.	Bilanci Energjetik.....	3
II.	Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM)	5
A.	Hyrje.....	5
B.	Rregulla për Vendosjen e Çmimeve.....	5
C.	Llogaritja e HLM në Minierat me Linjit	5
a)	Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (KOM)	7
b)	Zhvlerësimi i Lejuar (ZHLE)	7
c)	Kthimi në Kapital i Lejuar (KthKL)	7
d)	Kostot e Bartshme (KB)	8
e)	Pikat e tjera për t'u përfshirë në HLM	8
D.	Llogaritja e HLM për Gjenerim	8
a)	Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (KOM)	10
b)	Zhvlerësimi i Lejuar (ZHLE)	10
c)	Kthimi në Kapital i Lejuar (KthKL)	10
d)	Kostot e Furnizimit me Linjit (KFL)	11
e)	Kostot e Bartshme (KB)	11
E.	Çështja e Zbutjes	11
III.	Tarifat e Propozuara.....	12
A.	Përcaktuesit e Faturimit.....	12
B.	Klasifikimi i Kostove	13
C.	Tarifat e propozuara.....	14
	Shtojca A – SHPKA dhe Zbutja	15
	Shtojca B – Kostoja Mesatare e Ponderuar e Borxhit – Viti 2012.....	16
	Shtojca C – Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit sipas Divizionit të KEK-ut – Viti 2012	17

I. Hyrje

A. Përmbledhje

Ky Aplikim dorëzohet me plot respect në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) të Kosovës për aprovim të tarifave të rregulluara të propozuara për kapacitetet gjeneruese të Kosovës A dhe Kosovës B, të cilat janë licencuar nga ZRRE për Korporatën Energjetike të Kosovës Sh.a. (KEK). Propozohet që këto tarifa të hyjnë në fuqi që nga 1 prilli 2012.

Ligjet për energji të miratuara së fundi nga Qeveria e Kosovës, bashkë me Rregullat e reja për Caktimin e Çmimit, të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) kërkojnë që pronarët e kapaciteteve gjeneruese, Kosova A dhe B, të zhvillojnë dhe të dorëzojnë metodologjinë për përcaktimin e tarifave të rregulluara për shitje te Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike (FBEE). Përpara, metodologjia tarifore ishte zhvilluar nga ZRRE.

Tarifat e rregulluara për gjenerim, të propozuara nga ana e KEK-ut në këtë aplikim, janë bazuar në Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) vjetore për vitin e parë të periudhës së rregullatorit që të jenë 149,407,000 €, të cilat përfshijnë HLM-të për miniera, ashtu siç kërkohet nga Rregulla e ZRRE-së për Vendosijen e Çmimeve të Gjenerimit. Supozimet, vlerësimet dhe llogaritjet mbi të cilat është bazuar HLM për vitin 2012 janë dokumentuar në këtë aplikim.

Llogaritjet e bëra në këtë aplikim janë bazuar në informacionet që kemi këtu dhe në dokumentin e dorëzuar në ZRRE, i cili mban titullin “Pjesa I – Informatat Bazë për të Gjithë të Licencuarit”.

B. Definicionet

Me përjashtim kur shënohet ndryshe, definicionet e termeve në këtë dokument janë të njëjta me ato definicione në ligjet për energji të Kosovës dhe me ato që janë pjesë e Rregullave për Vendosijen e Çmimeve të miratuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

C. Bilanci Energjetik

Në mënyrë që të llogariten kostot e përgjithshme të prodhimit të energjisë elektrike nga gjeneratorët e rregulluar për Kosovë, Bilanci Energjetik zyrtar duhet të ofrojë pikën fillestare. Bilanci energjetik përshkruan sasinë e energjisë, të matur në kWh (ose MWh) që pritet të sigurohet te PBEE nga ana e gjeneratorëve të rregulluar. Energjia e prodhuar është proporcionale me sasinë e linjtit të

djegur nga secila njësi gjeneruese; prandaj, kostoja e prodhimit të linjitet mund të llogaritet gjithashtu.

Tabela 1 – Përmbledhja e Bilancit Energjetik 2012

Linja	Hyrje/Dalje	Sasia
Nr.	Përshkrimi	MWh
1	Gjenerimi Neto në Kosovën A (neto e gjithë Energj. Ndihm)	1,475.3
2	Gjenerimi Neto në Kosovën B (neto e gjithë Energj. Ndihm)	3,392.5
3	Gjenerimi i Ujmanit	82.0
4	Importi	820.8
5	Totali në Sistemin e Transmisionit (1 + 2 +3 + a4)	5,770.6
6	Shitjet e Transmisionit	744.6
7	Shfrytëzimi i KEK-ut	20.4
8	Minierat	111.0
9	Eksporti	169.8
10	Humbjet në Transmision	128.2
11	Teprica	13.3
12	Totali jashtë Transmisionit (6 + 7 + 8 + 9 + 10 + 11)	1,187.3
13	Neto në Sistemin e Distribucionit (5 - 12)	4,583.3
14	Gjenerimi i Lidhur i Distribucionit	51.5
15	Energjia e Shpërndarë në Kosovën Veriore nga KOSTT-i	203.7
16	Humbjet Teknike dhe Komerciale në Distribucion	1,543.3
17	Neto për Shitjet në Nivelin e Distribucionit (13 + 14 - 15 - 16)	2,887.8
	Shitjet në Nivelin e Distribucionit	
18	35 kV	40.0
19	10 kV	200.0
20	0.4 kV	2,647.8
21	Totali (18 + 19 + 20)	2,887.8

II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM)

A. Hyrje

Duhet të theksohet se nëse një marrëveshje për furnizim e një rëndësie të madhe aprovohet dhe nënshkruhet nga KEK-u dhe pronari i ri i KKDFE-së, metodologjia e propozuar këtu mund të zëvendësohet me anë të marrëveshjes, ashtu siç ka treguar më parë ZRRE.

B. Rregulla për Vendosjen e Çmimeve

Në "Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Regulluara të Gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit)", ZRRE ka aprovuar një periudhë rregullative shumëvjeçare në të cilën HLM dhe çmimet do të vendoseshin fillimisht në fillim të vitit të parë dhe pastaj do të përshtateshin në baza vjetore gjatë periudhës rregullative, duke përdorur një formulë të paracaktuar. Në fund të periudhës rregullative do të vlerësohen të dhënat bazë dhe do të vendosen çmimet fillestare për periudhën e ardhshme rregullative. Shtojca paraqet llogaritjet që do të përdoren në rast se përbërësit e caktuar të HLM do të "zbuteshin" sipas rregullës së vendosjes së çmimeve dhe algoritmeve që i ka siguruar ZRRE. Edhe pse mekanizmi "zbutës" mund të funksionojë mirë në një mjedis më statik të vendeve shumë të zhvilluara, ai nuk është opsion praktik për situatën e paqëndrueshme të gjenerimit në Kosovë, ashtu siç do të sqarohet në Seksionin E të këtij dokumenti. Po ashtu, popullsia e Kosovës nuk ka mundësi që ta përballojë majën e papritur në tarifën me pakicë, të cilat do të kërkonin zbatimin e "zbutjes" (d.m.th. "Zbutja" nëse "Zbutësi" shkakton rritje të madhe). Për arsyet e mësipërme, HLM për vitin 2012 do të bazohen në kostot e vitit 2012, dhe jo në një vlerë të zbutur.

C. Llogaritja e HLM në Minierat me Linjit

Tani, miniera me linjit është pronë e gjeneratorit të rregulluar dhe po ashtu operohet nga ai, prandaj, kostot do të përcaktohen duke përdorur fletët e punës për këtë llogaritje, ashtu siç janë paraqitur këtu, meqë Rregulla për Vendosjen e Çmimeve specifikon që HLM për miniera duhet të llogaritet në një mënyrë të ngjashme me atë të gjeneratorit të rregulluar.

HLM e vitit 2012 për operimin e minierave prej 70.7 milion € është paraqitur detajisht në Tabelën 2.

Tabela 2 – Të hyrat e Lejuara Maksimale të Furnizimit me Linjit për vitin 2012

ZHVILLIMI TARIFOR PËR GJENERIM

Përbërësi i Furnizimit me Linjit

në mijëra euro me përjashtim të vlerave për njësi

Të gjitha kostot e bazuara në vitin 2012

Përbërësi i Kostos:

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Operimi dhe Mirëmbajtja e Minierave	37,474
Alokimi i Kostove të Zyrës Qendrore	5,198
Energjia Elektrike për Operimin e Minierave:	
Konsumi nga Bilanci Energjetik (GWH)	111
Çmimi (euro për MWH)	59
Kostoja e Energjisë Elektrike për Miniera	6,549
TOTALI I OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES	49,221 = OPMC

Baza e Aseteve të Rregullatorit për Qëllime të Zhvlerësimit:

Kostoja më 1 janar 2012	280,370
Shtesat me 2012	28,000
Kostoja më 31 dhjetor 2012	308,370

Zhvlerësimi për vitin 2012

11,775 = DEPC

Zhvlerësimi i akumuluar mw 1 janar 2012	52,018
Zhvlerësimi për vitin 2012	11,775
Zhvlerësimi i akumuluar mw 31 dhjetor 12	63,793

Grantet:

Grantet më 1 janar 2012	53,394
Amortizimi i Granteve 2012	2,225
Grantet më 31 dhjetor 2012	51,169

RABf për Llogaritjen e Kthimit:

Fillimi i Vitit	174,958
Fundi i Vitit	193,408

Mesatarja për 2012 184,183

Norma e Kthimit për Miniera

Bazuar në Koston Mesatare të Kapitalit për vitin 2012 5.64%

Kthimi për vitin 2012

10,380 = RTNC

Kostot Kaluese:

Tantiema e Linjtit **2,030 = PSTC**

Pjesët e tjera:

Rregullimi për nënshpenzim në Shpenzimet Kapitale 2011(1,251)
Të hyrat nga Shitjet e Thëngjillit nga Pala e 3të (1,500)

Kostot e tjera totale **(2,751)**

Kostoja Totale në Gjenerimin e KEK-ut për Linjit

70,655 = LGSC

Kosto për ton (bazuar në 7,688,000 tonë të shpenzuar)

9.19

Vlerat për Kostot e Furnizimit me Linjit (KFL) në Tabelën 2 janë përcaktuar për përbërës të ndryshëm të formulës HLM në Planin 1 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit si në vijim:

a) Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (KOM)

Kostot e O&M për miniera në vitin 2012 (37.5 milion €) janë ato që janë përfshirë në buxhetin e KEK-ut për vitin 2012. Kjo është më e ulët se 42.2 milion € të aprovuara nga ZRRE në rishikimin tarifor të vitit 2011, në saje të fillimisht kontrollit më agresiv të kostos së materialeve dhe kostove të shërbimeve që janë duke u ndërmarrë nga KEK-u.

Alokimi i kostove të Zyrës Qendrore në miniera (5.2 milion €) është pak më i ulët sesa ato të aprovuara nga ZRRE në vitin 2011. Metoda e alokimit (numërimit) është e njëjtë me rishikimin e mëparshëm tarifor.

Në mjedisin e ri të shthurur, Furnizuesi Publik do të blejë energji nga Gjeneratori Publik në pikën e shpërndarjes në sistemin e transmisionit. Meqë minierat shfrytëzojnë energjinë nga sistemi i distribuicionit, ajo do të faturohet për atë energji nga ana e Furnizuesit Publik me tarifën e rregulluar. Kostoja e asaj energjie është përfshirë në kostot e O&M. Natyrisht, Furnizuesi Publik do të pasqyrojë këtë kredi të ardhurash në HLM-të e tij.

b) Zhvlerësimi i Lejuar (ZHLE)

Rregullat e reja për vendosjen e çmimeve kanë ricaktuar Bazën e Aseteve të Rregullatorit (BARr) dhe kanë përfshirë asetet para vitit 2006 në BARr. Pjesa I e Aplikimit Tarifor të KEK-ut ka ofruar një dokument të BARr-it që nga data 31 dhjetor 2011. Duke e përdorur atë si pikë fillestare, shtesat kapitale të vitit 2012 prej 28 milion € janë shtuar dhe zhvlerësimi për vitin 2012 ishte bazuar në bilancin mesatar të mjeteve themelore dhe në jetëgjatësinë 25 vjeçare të aseteve të minierave për të prodhuar një vlerë prej 11.8 milion € për zhvlerësimin e vitit 2012.

c) Kthimi në Kapital i Lejuar (KthKL)

Informatat e BARr në fund të vitit 2011 dhe informatat e WACC (Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit) në Pjesën I të aplikimit tarifor ofrojnë pikën fillestare për BARr dhe llogaritjet e kthimit për vitin 2012. Tabela 2 përdor atë informatë dhe inkorporon aktivitetin e prituri të vitit 2012 (SHPKA, zhvlerësimi, dhe amortizimi i granteve) për të arritur në një BARr mesatare për llogaritjen e kthimit. WACC për vitin 2012 është bazuar në mesataren e strukturës së kapitalit dhe kostove në fillim dhe fund të vitit 2012. Dokumentimi i kostos së borxhit për miniera dhe gjenerim është përfshirë në

Shtojcën B dhe dokumentimi për WACC për secilin divizion të KEK-ut në 2012 është përfshirë në Shtojcën C. WACC e 5.64% për miniera atëherë kur aplikohet në BARr mesatare prej 184 milion € jep një kthim prej 10.38 milion €.

d) Kostot e Bartshme (KB)

Tantiema e Linjtit përcaktohet në Rregullën e Vendosijes së Çmimeve si një “Kosto e Bartshme”. Tantiema e vitit 2012 vlerësohet të jetë 2.03 milion € duke supozuar se tantiema për tonë mbetet në nivelin aktual prej 0.26 € për ton.

e) Pikat e tjera për t’u përfshirë në HLM

HLM për vitin 2012 duhet të përmbajë dy përbërës shtesë. Meqë KEK-u nuk ka shpenzuar shumën totale të SHPKA të lejuara në tarifatat për vitin 2011, në vitin 2012 duhet të bëhet një rregullim për të pasqyruar zhvlerësimin dhe kthimin në sasinë e pashpenzuar.

Përveç kësaj, HLM duhet të rregullohet me anë të të ardhurave të pritshme për shitjen e thëngjillit (1.5 milion €)

D. Llogaritja e HLM për Gjenerim

HLM e Gjenerimit për vitin e parë të Periudhës Rregullative llogaritet ashtu siç është paraqitur në Tabelën 3. Tabela inkorporon HLM për operimin në minierave të llogaritur në Tabelën 2.

Tabela 3 – Të Hyrat e Lejuara Maksimale në Gjenerim për vitin 2012

ZHVILLIMI TARIFOR PËR GJENERIM

në mijëra euro me përjashtim të vlerave për njësi
Të gjitha kostot e bazuara në vitin 2012

Përbërësi i Kostos:

Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Operimi dhe Mirëmbajtja e Minierave		27,221	
Alokimi i Kostove të Zyrës Qendrore		2,573	
Energjia Elektrike nga Sistemi për Energjinë Ndhëmëse:			
Konsumi nga Bilanci Energjetik (GWH)	154.7		
Çmimi (euro për MWH)	56		
Kostoja e Energjisë për Miniera		8,663	
TOTALI I KOSTOVE TË OPERIMIT DHE MIRËMBAJTJES		38,457	=OPMC

Baza e Aseteve të Rregullatorit për Qëllime të Zhvlerësimit:

Kostoja më 1 janar 2012	268,905
shtesat në 2012	60,770
Kostoja më 31 dhjetor 2012	329,675

Zhvlerësimi për vitin 2012

Jetëgjatësia e Aseteve në vite që nga viti 2012	16	18,706	=DEPC
Zhvlerësimi i Akumuluar më 1 janar 2012	113,796		
Zhvlerësimi për vitin 2012	18,706		
Zhvlerësimi i akumuluar më 31 dhjetor 2012	132,502		

Grantet:

Grantet më 1 janar 2012	28,538
Amortizimi i Granteve 2012	1,903
Grantet më 31 dhjetor 2012	26,635

RABf për Llogaritjen e Kthimit:

Fillimi i Vitit	126,571
Fundi i Vitit	170,538
Mesatarja për 2012	148,555

Norma e Kthimit për Miniera

Bazuar në Koston Mesatare të Kapitalit për vitin 2012	12.64%
---	--------

Kthimi për vitin 2012

18,778 =RTNC

Kostot e Furnizimit me Linjit

70,655 = LGSC

Kostot Kaluese:

Taksa e Licencës së Gjeneratorit	521	
Taksa e KOSTT-it për Kosovën A dhe B	3,300	
TOTALI i Kostove Kaluese		3,821 =PSTC

Pjesët e tjera:

Rregullimi për nënshpenzim në Shpenzimet Kapitale 2011	(710)	
Të hyrat nga Shitja e Hirit	(300)	
Totali i Kostove të Tjera		(1,010)

Kostoja Totale e Gjenerimit të Kosovës A dhe B

149,407 =MAR

Prodhimi (Neto GWH)

5,023

Kostoja e Gjenerimit (euro për MWH)

29.75

Vlerat për përbërësit e HLM në Tabelën 3 janë përcaktuar për përbërës të ndryshëm të formulës së HLM në Planin 1 të Rregullës së Vendosijes së Çmimeve si në vijim:

a) Kostot e Operimit dhe Mirëmbajtjes (KOM)

Kostot e O&M për gjenerim në vitin 2012 (27.2 milion €) janë ato që përfshihen në buxhetin e KEK-ut për vitin 2012. Kjo është vlerë më e vogël se 30.8 milion € të aprovuara nga ZRRE në rishikimin tarifor të vitit 2011, në sja të fillimisht kontrollit më agresiv të kostos së materialeve dhe kostove të shërbimeve që janë duke u ndërmarrë nga KEK-u.

Alokimi i kostove të Zyrës Qendrore në gjenerim (2.6 milion €) është përafërsisht vlerë e njëjtë me atë të aprovuar nga ZRRE në vitin 2011. Metoda e alokimit (numërimit) është e njëjtë me rishikimin e mëparshëm tarifor.

Kosova A dhe Kosova B kërkojnë Energjia Ndhmëse në mënyrë që të operojnë. Rreth 75% e asaj energjie sigurohet nga vetë termocentrali, përderisa pjesa tjetër sigurohet nga rrjeti i distribuicionit në 35 KV dhe 10 KV. Duke ditur ndarjen e Rrjetit dhe Furnizimit nga KEK-u, ajo energji e furnizuar nga sistemi i distribuicionit duhet të paguhet në tarifat me pakicë, ngjashëm me energjinë e shfrytëzuar nga minierat. Kostoja e asaj energjia përfshihet në kostot O&M. Natyrisht, Furnizuesi Publik do të pasqyrojë këtë kredi të hyrash në HLM-të e tij.

b) Zhvlerësimi i Lejuar (ZHLE)

Rregullat e reja për vendosjen e çmimeve kanë ricaktuar Bazën e Aseteve të Rregullatorit (BARr) dhe kanë përfshirë asetet para vitit 2006 në BARr. Pjesa I e Aplikimit Tarifor të KEK-ut ka ofruar një dokument të BARr-it që nga data 31 dhjetor 2011. Duke e përdorur atë si pikë fillestare, shtesat kapitale të vitit 2012 prej 60.77 milion € janë shtuar dhe zhvlerësimi për vitin 2012 ishte bazuar në bilancin mesatar të mjeteve themelore dhe në jetëgjatësinë 16 vjeçare të asetëve të gjenerimit për të prodhuar një vlerë prej 18.7 milion € për zhvlerësimin e vitit 2012.

c) Kthimi në Kapital i Lejuar (KthKL)

Informatat e BARr në fund të vitit 2011 dhe informatat e WACC (Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit) në Pjesën I të aplikimit tarifor ofrojnë pikën fillestare për BARr dhe llogaritjet e kthimit për vitin 2012. Tabela 3 përdor atë informatë dhe inkorporon aktivitetin e pritur të vitit 2012 (SHPKA, zhvlerësimi, dhe amortizimi i granteve) për të arritur në një BARr mesatare për llogaritjen e kthimit.

WACC për vitin 2012 është bazuar në mesataren e strukturës së kapitalit dhe kostove në fillim dhe fund të vitit 2012. Dokumentimi i kostos së borxhit për miniera dhe gjenerim është përfshirë në Shtojcën B dhe dokumentimi për WACC për secilin divizion të KEK-ut në 2012 është përfshirë në Shtojcën C. WACC prej 12.64% për Gjenerim atëherë kur aplikohet në BARr mesatare prej 148.6 milion € jep një kthim prej 18.78 milion €

d) Kostot e Furnizimit me Linjit (KFL)

Kostot e Furnizimit me Linjit prej 70.66 milion € ashtu siç janë përcaktuar në Tabelën 2 janë një përbërës i HLM të Gjenerimit.

e) Kostot e Bartshme (KB)

Taksa e Licencës së Gjeneratorit përcaktohet në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve si një “Kosto e Bartshme”. Taksa e vitit 2012 vlerësohet të jetë 521,000 € në vitin 2012.

Kostoja e dytë e bartshme është taksa e KOSTT-it për Operatorin e Sistemit dhe Operatorin e Tregut, të cilat i ngarkohen Kosovës A dhe Kosovës B> ato janë supozuar të jenë 3.3 milion € në vitin 2012.

f) Pikat e tjera për t’u përfshirë në HLM

HLM për vitin 2012 duhet të përmbajë dy përbërës shtesë. Meqë KEK-u nuk ka shpenzuar shumën totale të SHPKA të lejuara në tarifat për vitin 2011, në vitin 2012 duhet të bëhet një rregullim për të pasqyruar zhvlerësimin dhe kthimin në sasinë e pashpenzuar.

Përveç kësaj, HLM duhet të rregullohet me anë të të ardhurave të pritshme për shitjen e hirit (300,000€)

KEK-u rekomandon që ZRRE të rishikojë dhe aprovojë HLM-të e propozuara për vitin 2012 për Gjeneratorin Publik prej 149,407,000 €.

E. Çështja e Zbutjes

Rregulla për Vendosjen e Çmimeve përdor një qasje shumëvjeçare për tarifa dhe në rastin e Gjeneratorin Publik propozohet një periudhë katër vjeçare. Koncepti i “Zbutjes” është paraqitur përmes së cilit përbërësit e caktuar të HLM llogariten për tërë periudhën 4 vjeçare, duke përdorur indeksat e inflacionit, dhe vlerësimet e ndryshme, duke përdorur shpenzimet kapitale të paracaktuara. KEK-u ka bërë këto llogaritje për Gjenerim dhe rezultatet janë paraqitur në Shtojcën A.

Për përbërësin e Zhvlerësimin të HLM, kërkohet një vlerësim i shpenzimeve kapitale për periudhën 2013 – 2015. Aktualisht, KEK-u planifikon të përfundojë instalimin e Elektrofiltrave në këto tri njësi të

Kosovës A, pastaj riparimet kapitale të njësive A4 dhe A5, dhe përfundimin e projekteve të tjera të gjenerimit në zhvillim e sipër. Përveç këtyre, zëvendësimet kapitale normale priten të ndodhin, të cilat rezultojnë në rreth 30 milion € të SHPKA për vit. Duhet të theksohet se ky parashikim NUK parasheh një program për vazhdimin e jetëgjatësisë së Kosovës A dhe Kosovës B, gjë që mund të kërkohej për shkak të faktit se kapaciteti gjenerues i Kosovës së Re nuk do të jetë në dispozicion deri rreth vitit 2020.

Edhe me SHPKA relativisht modeste të parashikuara për 3 vitet e ardhshme, vlera e zhvlerësimit të zbutur është 25.3 milion € në krahasim me vlerën 18.7 milion € të llogaritur vetëm për vitin 2012 (një rritje prej 35%). Kjo rritje prej 35% është në maje të rritjes së nevojshme vetëm për vitin 2012.

Ngjashëm, për përbërësin e kthimit të HLM, vlera e zbutur është 22.4 €, ashtu siç është paraqitur në Shtojcën A, krahasuar me 18.8 milion € vetëm për vitin 2012 (një rritje prej 19%).

Përbërësi i Operimit dhe Mirëmbajtjes është 40.0 milion € krahasuar me 38.5 milion €.

Meqë HLM e propozuar e gjenerimit, bazuar vetëm në kostot e vitit 2012, do të kërkojë një rritje të konsiderueshme të tarifave me pakicë (pjesërisht për shkak të shtimit të aseteve para vitit 2006 në BARr), nuk është e përshtatshme që të implementohet zbutja, e cila ka ndikimin e rritjes edhe më të madhe të çmimeve me pakicë në vitin 2012, një lëvizje kjo që do të jetë shumë e vështirë për ta zbatuar politikisht. Një mënyrë tjetër e vështrimit të kësaj çështje është që zbutja përgjithësisht përdoret për të parandaluar rritjet e papritura të tarifave, megjithatë në situatën e Kosovës, ku çmimet në të kaluarën kanë qenë arbitrarisht të ulëta, ndikimi është për të krijuar një rritje pak më të madhe. Për këto arsye, KEK kërkon nga ZRRE të mos e aplikojë zbutjen për momentin.

Dizajnimi i propozuar tarifar për të mbuluar HLM-të është paraqitur në Seksionin III, Tarifat e Propozuara.

III. Tarifat e Propozuara

Tarifat për gjenerim përcaktohen duke pjesëtuar HLM e alokuar me përcaktuesit e faturimit.

A. Përcaktuesit e Faturimit

Rregulla e Vendosijes së Çmimeve të Gjenerimit thekson se “Ngarkesat për kapacitet do të shprehen në euro për njësi të kapacitetit në dispozicion për orë”. Rregulla për Vendosijen e Çmimeve po ashtu thotë se ZRRE do të zhvillojë dhe paraqesë një metodologji për llogaritjen e Disponueshmërisë për çdo orë.

Deri më 31 dhjetor 2011, ZRRE ende nuk e ka paraqitur metodologjinë e tillë. Meqë Rregulla e Vendosijes së Çmimeve të Gjenerimit thekson se: “Rregullatori do të iniciojë shqyrtimin periodik jo

më vonë se 120 ditë pune para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative” dhe janë më pak se 90 ditë deri në fillimin e periudhës rregullative, prandaj nuk ka kohë për implementimin e një mekanizmi kompleks për vendosjen e çmimeve të disponueshmërisë. Në tregjet ku përdoret vendosja e çmimeve të disponueshmërisë, ekzistojnë rregullat e detajizuara mbi mënyrën se si do të përcaktohet disponueshmëria në një mjedis të kohës reale. Do të merrte shumë kohë për zhvillimin e rregullave dhe nuk ka kohë për këtë në një mjedis të hapur transparent për përdorim në këtë rishikim tarifor. Përveç kësaj, KEK-u mendon se vendosja e çmimeve të disponueshmërisë është një mekanizëm i rrezikshëm kur bëhet fjalë për njësi gjeneruese të vjetra dhe që shpesh ndërpriten për shkaqe të ndryshme. KEK-u është i gatshme që të bashkëpunojë me ZRRE gjatë vitit 2012 në zhvillimin e një mekanizmi alternativ për mbulimin e kostove fikse të kapaciteteve gjeneruese. Deri atëherë, propozohet që kostot fikse të pjesëtohen me 12 dhe kostoja t’i ngarkohet Furnizuesit bashkë me ngarkesën për energji për çdo muaj.

Çmimet për energjinë elektrike të furnizuar nga gjeneratori janë ndarë në dy përbërës: një ngarkesë fikse dhe një ngarkesë të energjisë. Ngarkesa fikse bazohet në kostot fikse të gjenerimit dhe minierave. Ato janë kosto që nuk ndryshojnë me vëllimin e energjisë elektrike të prodhuar. Në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve, ZRRE-ja përcakton kostot e ndryshueshme si kosto që nuk do të paraqiteshin në rast se njësitë e furnizuara për çdo vit do të ishin zero. KEK-u ka ndjekur atë rrugë në klasifikimin e kostove. Prandaj, është e përshtatshme që ngarkesa fikse të jetë thjesht kosto fikse vjetore (përcaktuar me anë të llogaritjes së HLM-ve) pjesëtuar me 12 muaj, duke rezultuar në këtë mënyrë në një ngarkesë fikse mujore.

Energjia e ngarkuar bazohet në kostot e ndryshueshme dhe lidhet drejtpërdrejt me vëllimin e energjisë elektrike të prodhuar. Me përdorimin e këtij definicioni, përcaktuesi i faturimit për ngarkesat e energjisë llogaritet duke përdorur të dhënat nga kWh e prodhuara vjetore (përfshijtur këtu energjinë ndihmëse jashtë vendit) dhe shitjet te Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike.

B. Klasifikimi i Kostove

Kostot që përfshihen në llogaritjen e HLM janë klasifikuar (ndarë) në ato fikse dhe ato të ndryshueshme. Klasifikimi i kostove gjeneruese është paraqitur në këtë tabelë.

Linja Nr.	(A) Përbërësi HLM	(B) Pikat	(C) Kostot Fikse ('000) €	(D) Kostot e Ndryshueshme ('000) €	(E) Kostot Totale ('000) €
1	KOM _t	Operimi & Mirëmbajtja	24,719€	11,165€	35,884€
2	ZHLE _t	Zhvlerësimi Total	18,706€		18,706€
3	KThKL _t	Kthimi Total	18,778€		18,778€
4	KFL _t	Kostot e Lejuara të Linjtit	62,076€	8,579€	70,655€
5	KTK _t	Kostot e tjera të karburantit	(710€)	(300€)	(1,010€)
6	KB _t	Kostot e Batshme Totale	521€	3,300€	3,821€
7	KZQ _t	Kostot e Zyrës Qendrore	2,573€		2,573€
8	Totali i HLM të Gjenerimit		126,663€	22,744€	149,407€

Dokumentet e tjera të detajzuara në dispozicion sipas kërkesës.

C. Tarifat e propozuara

Tarifat e propozuara të cilat faturohen në baza mujore janë nga tabela e mësipërme dhe bilanci energjetik:

Ngarkesa Fikse: Nga Tabela, 126,663,000€ /12

10,555,250€ /muaj

Ngarkesa e Energjisë: Nga Tabela, 22,744,000 € /5,022.5 GWH (nga bilanci energjetik, neto e Energjisë Ndhmëse jashtë vendit)

4.53 € /MWh

Shtojca A – SHPKA dhe Zbutja

Meqë Periudha Rregullative është shumëvjeçare, Rregulla e Vendosijes së Çmimeve të Gjenerimit tregon se HLM duhet të zbutet në mënyrë që të parandalojë rritjet e mëdha ndër vite, kur të përfundojnë SHPKA të reja. Prandaj, tabela vijuese përdoret për të llogaritur Vlerën Aktuale Neto të SHPKA të ardhshme, dhe siç duhet edhe llogaritjen e kostove vjetore të zhvlerësimit të përfshira në HLM, si dhe Kostot O&M.

ZHVILLIMI TARIFOR PËR GJENERIM

në mijëra euro me përjashtim të vlerave për njësi

Llogaritjet Shumëvjeçare

Skenari i Kapacitetit Jo Shtesë

Supozimi i të gjitha Importeve të Rritura që Kërkojnë Rritje të Ngarkesës

		2012	2013	2014	2015
Rritja e përqindjes së HICPI	(Supozim)	3%	3%	3%	3%
BARr për Zhvlerësim					
	Bilanci Fillestar i Kostos		339,565	380,652	422,972
	Shtesat		30,000	30,000	30,000
	Kostoja në fund të vitit	329,675	369,565	410,652	452,972
Zhvlerësimi:					
	Jetëgjatësia e Mbetur (në vite)	16	15	14	13
	Zhvlerësimi për vit	18,706	23,638	28,261	33,690
	Zhvlerësimi i zbutur:				
	NPV	75,939			
	Anuiteti	25,340	25,340	25,340	25,340
Zhvlerësimi i Akumuluar					
	Fillimi i Vitit		136,477	164,918	198,974
	Zhvlerësimi për vit		23,638	28,261	33,690
	Fundi i Vitit	132,502	160,114	193,179	232,664
Grantet					
	Fillimi i Vitit		27,434	26,238	24,946
	Amortizimi për vit	1,903	1,960	2,019	2,079
	Fundi i vitit	26,635	25,474	24,219	22,866
BARr për llogaritjen e kthimit					
	Fillimi i vitit		175,655	189,496	199,052
	Fundi i vitit	170,538	183,977	193,254	197,441
	Mesatarja	148,555	179,816	191,375	198,247
	Norma e Kthimit	12.64%	12.64%	12.64%	12.64%
	Kthimi për vit	18,778	22,729	24,191	25,059
	Kthimi i zbutur				
	NPV	67,078			
	Anuiteti	22,383	22,383	22,383	22,383
Operimi dhe Mirëmbajtja					
	HICPI	3%	3%	3%	3%
	Faktori i Efikasitetit	0%	0%	0%	0%
	OWM e zbutur:				
	NPV	120,013			
	Anuiteti	40,047	40,047	40,047	40,047

Shtojca B – Kostoja Mesatare e Ponderuar e Borxhit – Viti 2012

Struktura e Kapitalit dhe Kosto e Kapitalit Mesatare për vitin 2012

Borxhi Afatgjatë më 31 dhjetor 2011				
(në mijëra euro)				
		Kryegjësja	Norma e Int	Kosto e Ponderuar
<u>Minierat:</u>				
Kredia e Sibovcit JP #1	75,000	7.43%		3.68%
Kredia e Sibovcit JP #2	58,445	6.00%		2.32%
Kredia e Sibovcit JP #3	17,942	6.00%		0.71%
	151,387			6.71%
<u>Gjenerimi:</u>				
Rehabilitimi i A5	9,400	7.43%		2.67%
Rehabilitimi i B1 & B2	5,400	6.00%		1.24%
Riparimi i B1 & B2	11,353	6.00%		2.60%
	26,153			6.51%
Kosto Përbërëse e Borxhit	177,540			6.68%

Kredia e SJP #1 do të fillojë të paguhet në 16 kështe gjysmëvjetore që fillojnë në janar të vitit 2012
 Kredia e SJP #2 do të ngrihet në Bilanc më 31 dhjetor 2011 - kthimi gjysmëvjetor fillon në janar 2012
 Kredia e SJP #3 do të përdoret për 15 milion euro të Shpenzimeve Kapitale në 2012 pastaj të ngrihet - kthimi fillon më 2013
 3 kreditë për Gjenerim do të fillojnë të kthehen në janar të vitit 2012 (në 16 kështe të barabarta gjysmëvjetore)

Borxhi Afatgjatë më 31 dhjetor 2012				
(mijëra euro)				
		Kryegjësja	Norma e Int	Kosto e Ponderuar
<u>Minierat:</u>				
Kredia e Sibovcit JP #1	65,625	7.43%		3.26%
Kredia e Sibovcit JP #2	51,139	6.00%		2.05%
Kredia e Sibovcit JP #3	32,942	6.00%		1.32%
	149,706			6.63%
<u>Gjenerimi:</u>				
Rehabilitimi i A5	8,225	7.43%		2.67%
Rehabilitimi i B1 & B2	4,725	6.00%		1.24%
Riparimi i B1 & B2	9,934	6.00%		2.60%
	22,884			6.51%
Kostoja Përbërëse e Borxhit	172,590			6.61%

Shtojca C – Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit sipas Divizionit të KEK-ut – Viti 2012

Struktura e Kapitalit dhe Kostoja Mesatare e Kapitalit për vitin 2012

Struktura e Kapitalit						
	Miniera			Gjenerimi		
	1-Jan-12	31-Dec-12	Average	1-Jan-12	31-Dec-12	Mesatarja
Baza e Aseteve të Rregulluara	174,958	193,408	184,183	126,571	170,538	148,555
Borxhi Afatgjatë	151,387	149,706	150,547	26,153	22,884	24,518
Komponenta e Ekuitetit	23,571	43,702	33,636	100,418	147,654	124,036
Leverazhi	0.865	0.774	0.817	0.207	0.134	0.165

Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit sipas Divizionit						
WACC = (1 - g) * (rE) / (1 - t) + g * (rD)						
	Miniera			Gjenerimi		
	1-Jan-12	31-Dec-12	Average	1-Jan-12	31-Dec-12	Mesatarja
Leverazhi (g)	0.865	0.774	0.817	0.207	0.134	0.165
Kthimi i Ekuitetit (rE)	13.00%	13.00%	13.00%	13.00%	13.00%	13.00%
Kostoja e Borxhit (rD)	3.71%	3.63%	3.67%	3.51%	3.51%	3.51%
Norma Tatimore (t)	10%	10%	10%	10%	10%	10%
WACC	5.15%	6.07%	5.64%	12.19%	12.98%	12.64%